

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

**Një ankesë kundër: MINISTRIA E ARSIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

|                        |                                     |
|------------------------|-------------------------------------|
| <b>Nr i Prokurimit</b> | <b>208 Udheheqesi-25-3147-5-1-1</b> |
| <b>Nr i brendshëm</b>  | <b>208025035511</b>                 |

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i SHFMU në Kaçanik**

### ANKESË

**Identifikimi i ankuesit:**

**"R & Rukolli" SH.P.K.**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**18 Qershori, Skenderaj**

*(Adresa)*

**Skenderaj**

*(Vendi)*

**41000**

*(Kodi postar)*

**+383 (49) 309213**

*(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it)*

**Ragip Behrami**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**r.rukolli@hotmail.com**

*(Adresa elektronike)*

**10.06.2026**

*(Data e parashtrimit të kërkesës)*



## 2. Identifikimi i avokatit

Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës) (Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].*

1. **B05 Njoftimi për kontratë - me datë 13/06/2025**
2. **B54 Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 15/09/2025**
3. **B54 Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 22/09/2025**
4. **B54 Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 23/09/2025**
5. **B12 Hapja e ofertave me datë 30/09/2025**
6. **B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së 21/11/2025**
7. **Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm 21/11/2025**
8. **B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së 22/05/2026**
9. **Letër standarde për tenderuesin e eliminuar 22/05/2026**
10. **Kërkesa për ri-shqyrtim me datë 26.05.2026**
11. **Vendimi i AK-së lidhur me kërkesën për ri-shqyrtim me datë 01.06.2026**

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. **Neni 1 Qëllimi i ligjit**
2. **Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
3. **Neni 7 Barazia dhe trajtimi / Jo-Diskriminimi dhe Transparenca.**
4. **Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve**
5. **Neni 60 Kriteret për dhënien e kontrates**
6. **Neni 69 Aftësia teknike ose/dhe profesionale pika 6.3**
7. **Dokumentacioni dhe informacioni shtesë 01/022 për prokurimin publik RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK**

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

1. **Nuk është respektuar Neni 1 pika 1 e LPP-së,** (Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive dhe transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, AK dhe komisioni i vlerësimit ka shkelur këtë nen të ligjit të prokurimit publik duke rekomanduar si fitues grupin e OE të papërgjegjshëm për dhënie të kontratës, OE që nuk i plotëson kriteret për dhënie të kontratës.
2. **Nuk është respektuar Neni 6 pika 1 dhe 2 e LPP-së,** ky Nen parasheh që "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike" ndërsa AK ka bërë shkelje të këtij neni duke shpërblyer me kontratë një OE i cili është me çmim më të lartë për 721,132.11 Euro apo 14.21% me shtrenjtë se sa oferta jonë e cila është e përgjegjshme.
3. **Nuk është respektuar Neni 7 pika 1 e LPP-së,** (Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente, duke na diskriminuar ne si OE të përgjegjshëm me çmim më të lirë. AK dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim dhe nuk ka respektuar këtë nen të LPP-së.
4. **Nuk është respektuar Neni 59 dhe Neni 60 i LPP-së)** sepse komisioni i vlerësimit ka obligim ligjor të jetë i paanshëm, transparent dhe të veprojë konform kriterëve të dosjes së tenderit.
5. **Nuk është respektuar Neni 69, Aftësia teknike ose/dhe profesionale,** Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2 e Dosjes së tenderit (Pika 1, 2 dhe pika 3).

**Vendimi i AK është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, parimet themelore të barazisë, proporcionalitetit, transparencës dhe sigurisë juridike.**

- Me datë 21.11.2025, Autoriteti Kontraktues kishte shpallur si fitues dhe **OE të përgjegjshëm**, kompaninë tonë R & Rukolli SH.P.K. me vlerë 5,072,587.34 euro. Pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim nga operatorë të tjerë ekonomikë, AK kishte refuzuar kërkesat për ri-shqyrtim si të pa bazuara. Megjithatë pas ankesave të dorëzuara në OSHP nga GOE "LimitProject" sh.p.k & "Rinesa" sh.p.k. dhe vetëm mbi bazën e raportit të ekspertit shqyrtues (i cili është vetëm dokument paraprak, këshillues dhe jo-detyrues për AK), AK ka vendosur ta ndryshoj vendimin fillestar pa e lejuar që ankesa të shqyrtohet edhe nga paneli shqyrtues i cili përbën organin më të lartë vendimmarrës dhe garantues të ligjshmërisë në procedurat ankimore të prokurimit publik.

Në këtë mënyrë me datë 20.05.2026 AK ka rekomanduar si fitues GOE "LimitProject" sh.p.k & "Rinesa" sh.p.k, ndërsa kompaninë tonë e ka eliminuar si operator ekonomik të papërgjegjshëm, **duke u mbështetur në interpretime të pasakta dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.**

Arsyetimi i përdorur për eliminim është i pabazuar në prova konkrete dhe interpretimi i njëanshëm i bërë nga eksperti shqyrtues dhe i aplikuar nga AK.

**Sa i përket pretendimit 1 dhe 3 të vendimit të AK-së** të datës 22.05.2026, lidhur me kontratat mbi vepër, nuk pajtohem me këtë vlerësim për faktin se, sipas Ligjit Nr. 03/L-212 për Punën, kontrata mbi vepër krijon marrëdhënie juridike dhe angazhim të vlefshëm ndërmjet operatorit ekonomik dhe profesionistit për realizimin e projektit konkret.

Kontratat e paraqitura nga ne hyjnë në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës me Autoritetin Kontraktues dhe garantojnë angazhimin e stafit profesional gjatë realizimit të projektit. Ndërsa parakontrata paraqet vetëm një zotim paraprak ndërmjet palëve, pa efekt detyrues të menjëhershëm për realizim të punëve. Sipas **nenit 33 të LMD-së**, parakontrata është vetëm kontratë me të cilën merret përsipër detyrimi që në të ardhmen të lidhet kontrata kryesore. Pra, parakontrata nuk është vetë kontrata kryesore dhe nuk krijon menjëherë marrëdhënien përfundimtare të angazhimit. Në anën tjetër, **sipas nenit 615 të LMD-së**, me kontratën mbi vepër personeli profesional dhe teknik detyrohet të kryejë një punë të caktuar fizike ose intelektuale, ndërsa punëdhënësi detyrohet të paguajë shpërblimin. Kjo nënkupton se kontrata mbi vepër është kontratë e plotë dhe detyruese.

Rrjedhimisht, kontratat mbi vepër të paraqitura nga kompania jonë e përmbushin plotësisht kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe dëshmojnë në mënyrë të mjaftueshme disponueshmërinë e stafit profesional dhe teknik për realizimin e kontratës.

Megjithatë, vendimi i AK-së është kontradiktor dhe diskriminues, pasi i njëjti standard nuk është aplikuar ndaj GOE të rekomanduar si fitues. Konkretisht, GOE "LimitProject" sh.p.k. & "Rinesa" sh.p.k. ka paraqitur shumicën e stafit profesional dhe teknik po ashtu me kontrata në vepër, të cilat AK i ka konsideruar të pranueshme.

Në këtë mënyrë, AK ka aplikuar standarde të dyfishta, duke shkelur drejtpërdrejt **nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim / Mosdiskriminimi dhe Transparenca.**

Stafi profesional dhe teknik që GOE "LimitProject" sh.p.k & "Rinesa" sh.p.k. ka të lidhur kontratë në vepër me ta janë si në vijim:

1. Afrim Prokshi, inxhinier i elektroteknikës (kontratë në vepër),
2. Liridona Berisha, arkitekte, udhëheqëse e punishtes (kontratë në vepër),
3. Jeton Gashi, inxhinier i makinerisë (kontratë në vepër),
4. Remzi Selimi, inxhinier i makinerisë (kontratë në vepër),
5. Milot Lubishtani, gjeodet (kontratë në vepër),
6. Adrian Kadiri, gjeoteknikë (kontratë në vepër),
7. Floriana Osmani, IT (kontratë në vepër),
8. Reshat Krasniqi, teknik i hidros (kontratë në vepër),
9. Bahri Olluri, përpunues i drurit (kontratë në vepër),
10. Alban Podrimqaku, skelist (kontratë në vepër),
11. Samedin Krasniqi, manipulues i makinerive (kontratë në vepër),
12. Mustafë Topalli, zdruthëtar (kontratë në vepër),
13. Artan Tovërlani, teknik i arkitekturës (kontratë në vepër),
14. Meriton Sopi, teknik i ngrohjes (kontratë në vepër),
15. Muhedin Krasniqi, drenazhues (kontratë në vepër),

Prandaj, eliminimi i kompanisë sonë mbi këtë bazë është **selektiv, diskriminues dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit publik.**

#### **Lidhur me pretendimin 2 të AK-së**

Sa i përket pretendimit lidhur me Menaxherin Kryesor të Punëve të Makinerisë / HVAC, kompania jonë ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme që provojnë specializimin profesional të personit të propozuar në sistemet HVAC, përmes certifikatës së trajnimit dhe specializimit të dorëzuar në dokumentacionin e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i AK-së është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e paraqitur.

#### **Lidhur me pretendimin 4 të AK-së**

Sa i përket pretendimit lidhur me inxhinierin e gjeodezisë, kompania jonë ka paraqitur gjeodet të diplomuar në vitin 2016, i cili posedon mbi 9 vite përvojë profesionale, duke përbushur dhe tejkaluar kriterin e kërkuar nga AK.

Licenca profesionale është dokument administrativ i rinovueshëm periodikisht që vazhdohet në periudha 5 vjeçare dhe nuk mund të konsiderohet si element përcaktues i përvojës profesionale të kandidatit.

Për rrjedhojë, eliminimi mbi këtë bazë është juridikisht i paqëndrueshëm.

#### **Lidhur me pretendimin 5 të AK-së**

Sa i përket pretendimit për inxhinierin e gjeoteknikës, personi i propozuar nga kompania jonë tejkalon kriteret e kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Pretendimi i AK-së për "mbi-kualifikim" përbën interpretim joprofesional dhe absurd juridikisht, nga ana e komisionit duke degraduar edhe vetë institucionin nga i cili nxirret ky vendim (Ministria e Arsimit). Asnjë dispozitë e LPP-së nuk parashihet kualifikimin më të lartë si bazë për eliminim. Kriteret e DT-së përbushen kur kandidati ka plotësuar minimalisht kualifikimin e kërkuar dhe tejkalimi i tij është vetëm avantazh dhe nuk mund të përdoret si bazë për eliminim në një procedurë të prokurimit publik

## Parregullsitë në ofertën e GOE "LimitProject" sh.p.k. & "Rinesa" sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në kuadër të procedurës së prokurimit, kemi identifikuar një sërë mungesash dhe parregullsish në ofertën e tij të cilat e bëjnë ofertën e tij të papërgjegjshme në raport me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

GOE i rekomanduar ka paraqitur z. Afrim Prokshi si inxhinier të elektroteknikës, ndërkohë që sipas CV-së së dorëzuar, i njëjti është i punësuar me orar të plotë në Komunën e Drenasit dhe njëkohësisht është deklaruar me marrëveshje pune siç deklaroi OE në kontratën e tij në vepër.

Sipas Ligjit të Punës i Republikës së Kosovës L03/L-212, marrëdhënia e punës me orar të plotë nënkupton angazhim të plotë të punëmarrësit tek punëdhënësi, dhe punësimi në institucion publik ka karakter primar dhe obligues. Një i punësuar në sektorin publik është i detyruar të përmbushë detyrat gjatë orarit të plotë të punës (08:00 – 16:00) sipas ligjit të punës për shërbyesit publik, dhe nuk mund të jetë njëkohësisht i angazhuar në një projekt - aktivitet pune tjetër me orar të plotë sipas kontratës së prezantuar në dosjen e OE dhe sipas kërkesave të dosjes së AK. Andaj si i tillë nuk mund të jetë aktiv dhe prezent në dyja aktivitetet njëkohësisht sikur edhe tek OE privat gjatë periudhës së zhvillimit dhe të aktivitetit të projektit të synuar nga OE dhe detyrave të tij të angazhimeve si i punësuar në orar të plotë pranë KK Drenas. Angazhimi paralel me orar të plotë në dy subjekte është në kundërshtim me natyrën e marrëdhënies së punës, ligjin e punës dhe një situatë e tillë është praktikisht e pamundur dhe ligjërish e pabarazueshme sepse:

- Inxhinieri i propozuar nuk mund të jetë prezent me orar të plotë në realizimin e kontratës sipas detyrave të paraqitura në kontratën në vepër ndërmjet OE "LimitProject" & "Rinesa Sh.p.k, dhe inxhinierit Afrim Prokshi.

Gjithashtu nuk ka paraqitur bashkë me kontratën e punës edhe një dokument për lirimin nga detyra nga KK Drenas, për kohën e realizimit të projektit sipas planit dinamikë prej 18 muajsh apo dokumentin e pushimit për lirimin nga puna pa pagesë nga KK Drenas për 18 muaj.

- Roli i menaxherit kryesor të punishtes për instalime elektrike kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe mbikëqyrje direkte, që në këtë rast është i pamundur dhe poashtu duke marrë parasysh edhe rëndësinë e madhe dhe delikate të këtij projekti që kërkon angazhim të plotë për realizimin e këtij projekti.

Inxhinier i prezantuar i makinerisë Remzi Selimi nuk ka prezantuar licencën e inxhinierit sipas kërkesave të dosjes së tenderit por vetëm një vendim nga ODA, i cili nuk mund të zëvendësojë licencën e kërkuar nga AK dhe përbën shkelje të kritereve të vendosura nga AK në dosje të tenderit.

Gjithashtu për stafin teknik si në vijim nuk ka paraqitur listën e projekteve siç është kërkuar në dosje të tenderit.

9. Lista e stafit të OE, se paku (40) punëtor, ku disa prej tyre të jenë personel i kualifikuar me pesë viti përvojë pune pas diplomimit si një teknik i ndërtimtarisë, një teknik i arkitekturës, një teknik i ndërtimtarisë drejtimi Hidro, si dhe punëtor të trajnuar për punime armirues, latues; murator; suvatues; manipulues i makinerisë; skelistë; kranist, përpunues druri; instalues të ngrohjes dhe klimatizimit; instalues elektrik; një IT(kompjuterik) me përvojë pune tri vjeqare etj.

Dëshmia 9. Listën e punëtorëve të operatorit ekonomik, e njëjta duhet të dorëzohet origjinal ose kopje e noterizuar. Kontratat ose para kontratat mbi marrëdhënien e punës të punëtorëve, listën e projekteve të evidentuar dhe nënshkruar. Për personelin e kualifikuar (shkollat teknike profesionale) duhet të prezantohen diplomatë e shkollave profesionale të akredituara nga institucioni shtetëror. Ndërsa për punëtor të trajnuar duhet të prezantohen certifikatat e trajnimit nga institucione apo trupa certifikues të akredituara.

- Bahri Olluri (Përpunues i drurit)
- Alban Podrimçaku (Akelist)
- Samedin Krasniqi (Manipulues i makinerive),
- Mustafë Topalli (Zdrukthëtar),
- Hysni Deliu (Suvatues),
- Artan Tovërlani, (Teknik i arkitekturës),
- Vehbi Nebihi (Kranist),
- Granit Qorri (Armirues),
- Bekim Demaku (Teknik i ndërtimtarisë),
- Metush Smajli (Instalues elektrik),
- Artan Duraku (Instalues i ngrohjes),
- Meriton Sopi (Instalues i ngrohjes),

Mospërputhja e profilit të Mustafë Topallit

GOE ka paraqitur z. Mustafë Topalli si "latues", ndërkohë që dokumentacioni i dorëzuar dëshmon se i njëjti posedon certifikim si zdrukthëtar.

Këto janë profile profesionale të ndryshme dhe nuk mund të konsiderohen ekuivalente, pasi:

- latuesi merret me përgatitjen e kallepeve për betonim;
- ndërsa zdrukthëtar i me përpunimin e drurit për dyer dhe dritare.

Mungesa e certifikatave të trajnimit

Në dokumentacionin e paraqitur për teknikun instalues i ngrohjes Artan Duraku nuk ka prezantuar çertifikatën e trajnimit që dëshmon se i kualifikuar për pozitën e fillë sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Gjithashtu edhe për teknikun drenazhues Muhedin Krasniqi nuk ka prezantuar çertifikatën e trajnimit duke mos plotësuar kriterin e vendosur nga AK për këtë pozitë.

Shkelja e legjislacionit të punës lidhur me pagën minimale

Poashtu në kontratën e punës së teknikut Alban Ramadani ka deklaruar e cila është nën nivelin e pagës minimale të përcaktuar në Kosovë edhe në momentin e nënshkrimit të kontratës, sepse sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për pagën minimale: Nr.02/218 e datës 28.08.2024 ka përcaktuar pagën minimale në vlerë prej 350€, kurse OE në kontratën e teknikut ka paraqitur pagën në vlerë 230€, duke bërë shkelje të drejtpërdrejta të ligjit të punës paraprak që ishte në fuqi.

Bazuar në faktet dhe argumentet e mësipërme, në përputhje me Nenin 108 të LPP-së (Procedurat e rishqyrtimit), kërkojmë:

**Aprovojë ankesën tonë si të bazuar:**

**Anulimin e vendimit për dhënien e kontratës** për GOE të rekomanduar dhe rekomandimin si fitues të kompanisë sonë R & Rukolli sh.p.k.

**Rishqyrtimin e të gjithë procesit të vlerësimit** të ofertave dhe rivlerësimin konform dispozitave ligjore.

**Ne, si Operator Ekonomik ankues, të shpërblehemi** me kontratë pasi konsiderojmë se jemi Operatori Ekonomik me ofertën më të lirë dhe njëkohësisht i përgjegjshëm, duke plotësuar në tërësi të gjitha kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në dosjen e tenderit.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

1. Humbja e fitimit të pritur nga kontrata në vlerë të ofertuar 5,072,587.34€;
2. Shpenzimet e kryera për përgatitjen e ofertës, përfshirë burimet njerëzore, materiale dhe administrative;
3. Dëmtimi i reputacionit dhe i kapacitetit konkurrues në tregun e prokurimit publik;
4. Shpenzimet e procesit të përgatitjes së kërkesës për rishqyrtimit dhe ankesës.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit".
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues*